Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOMISIONI RREGULATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION

# Manual udhëzues për përgaditjen dhe publikimin e *Njoftimit B54 - Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara*

**Hyrje**

Ky manual udhëzues ka për qëllim dhënien e udhëzimeve për zyrtarët e prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese për përdorimin e Formularit B54 kurdo që është e dosmosdoshme të ndryshohet ose shtohet çfarëdo informacioni ose e dhënë e publikuar në një procedurë të prokurimit, apo informacione/të dhëna lidhur me:

- **Kërkesat e përshtatshmërisë, kapacitetit ekonomik financiar, kapacitetit teknik dhe professional**
- **Afatin kohorë për dorëzimin e ofertave/aplikacioneve**
- **Dosjen e Tenderit dhe Përshkrimin e Çmimeve**

Në vijim do të ilustrohen të gjithë hapat që përfshijnë përgaditjen dhe publikimin e njoftimit B54 nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, dhe të cilët duhet të ndjeken me kujdes nga të gjithë përdoruesit e autoriteteve kontraktuese.

## 0. Informata bazë



Të dhënat në këtë hap mbeten të pandryshuara

## 1. Informata të përgjithshme për prokurimin



Të dhënat në këtë hap mbeten të pandryshuara

## 2. Personi përgjegjës zyrtar




Të dhënat në këtë hap mbeten të pandryshuara

## 3. Lënda e kontratës




Të dhënat në këtë hap mbeten të pandryshuara

## 4. FPP, sasia apo fushëveprimi i kontratës




Të dhënat në këtë hap mbeten të pandryshuara

## 5. Lënda e kontratës /Pjesë(Lote)




Në këtë hap të dhënat mbeten të pandryshuara dhe nuk duhet të preken në asnjë mënyrë.

## 6. Kushtet në lidhje me kontratën




Në këtë hap të dhënat mbeten të pandryshuara

## 7. Kushtet për pjesëmarrje




Në këtë hap ju mund të ndryshoni apo editoni cilëndo kërkesë apo dëshmi të vendosur. Megjithate këshilloheni që mos të ndryshoni ndonjë të dhënë në këtë hap, meqenëse këtë duhet t'a bëni edhe në hapin e 12-të.

## 8. Informacionet administrative

Ky është hapi më i rëndësishëm nëse është e domosdoshme për të ndryshuar **afatet kohore për dorëzim të ofertave – shtyrje të afatit**




Këtu duhet të ndryshohet data – apo të vendoset data e re për dorëzim të ofertave.

Psh. Nëse afati aktual është data 10.05.2025 dhe nëse afati i ri duhet të jetë data 27.05.2025, ateherë data duhet të paraqitet si në ilustrimin më poshtë




Data 27.05.2025, te verifikohet dhe konfirmohet nese eshte ndryshuar/paraqitur edhe ne hapin e 13-të

## 9. Informata shtesë në njoftimin original




Në këtë hap të dhënat mbeten të pandryshuara

## 10. Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit




Në këtë hap të dhënat mbeten të pandryshuara

## 11. Informacioni që duhet të përmirësohet ose shtohet




Këtu duhet të zgjedhet "PO" për përmirësim gabimi dhe "Të dyja" për modifikim

## 12. Teksti i cili duhet te permiresohet ne njoftimin original

Ky hap është hapi kryesor dhe më i rëndësishëm për ndryshimin/shtimin e informacioneve ose të dhënave që kanë të bëjnë me kërkesat, dëshmitë, Dosjen e Tenderit dhe Përshkrimin e Çmimeve




Kur të kaloni në këtë hap gjithmonë paraqiten të dhënat të cilat janë të paraqitura në hapin e 7.

Për t'i vendosur të gjitha të dhënat që ju duhet të ndryshoni dhe shtoni, atëherë këshilloheni që të fshini të **gjithë rreshtat**. Fshirja bëhet duke shtypur **"X"**

Pas fshirjes së rreshtave, ky hap apo kjo dritare duhet të paraqitet si më poshtë:






Pas fshirjes të të gjithë rreshtave, shtoni rreshta për aq sa ka nevoje të shtohen

Per secilin rresht të shtuar, zgjedh llojin e korrigjimit, **ndryshon**, **shtohet** ose **fshihet.**

Nese lloji i korrigjimit zgjedhet **“Ndryshon”** atëherë të tre fushat (**Vendi i korrigjimit të tekstit, Në vend të** dhe **Lexo**) janë të editueshme.

Nese lloji i korrigjimit zgjedhet **“Shtohet”** atëherë vetëm dy fusha janë të editueshme (**Vendi i korrigjimit të tekstit,** dhe **Lexo),** sepse është duke u shtuar informacion ose e dhënë që nuk ekziston.

Nëse teksti në **Vendi i korrigjimit të tekstit** është i njejtë me tekstin e rreshtit paraprak, atëherë, atëherë kjo fushë nuk shfaqet, por që paraqitet në formularin/njoftimin e krijuar.

Më poshtë ilustrohet një shembull i plotësimit të fushave në hapin e 12-të




Në rreshtin e 2-të, njejtë si në rreshtin e parë, përshkruaj dëshminë aktuale dhe dëshminë e ndryshuar.  Ky opcion përdoret kur ka ndryshim edhe në kërkesë edhe në dëshmi. Në rast se ndryshohet vetëm njëra (kërkesa ose dëshmia), atëherë përdoret vetëm një rresht.

Në rast se në dokumentet e publikuara (B05, dhe DT), përveç Kushteve për Pjesëmarrje, duhet të ndryshohet ndonjë e dhënë që ka të bëjë me specifikimet teknike apo Përshkrimin e Çmimeve, atëherë këshilloheni të bëni përshkrimet si në rreshtat 5 dhe 6.

Nëse ndryshimi në DT në pjesën e specifikimeve teknike/Termave të referencës përfshinë sasi të madhe të tekstit, atëherë mjafton të specifikohet saktë vendi i ndryshimit, p.sh, pjesa, paragrafi, etj të cilat përfshihen në DT të ndryshuar.

E njejta si në paragrafin më lartë, vlenë edhe nëse në DT shtohet ndonjë e dhënë e re.

Në rastin e ndryshimeve në Përshkrim të Çmimeve, specifikohet emërtimi i përshkrimit të çmimeve që është publikuar dhe emërtimi i përshkrimit të çmimeve i ndryshuar. E rëndësishme është që palët e interesuara të njoftohen se ka ndryshim në pjesën e Përshkrimit të Çmimeve.

## 13. Datat të cilat duhet të përmirësohen në njoftimin origjinal

Në këtë hap verifikohen nëse të dhënat/datat e ndryshuara në hapin e 8-të janë paraqitur/bartur në mënyrë korrekte.




Nëse datat e paraqitura nuk janë të njejta sikur datat e vendosura në hapin e 8-të, atëherë duhet të ktheheni edhe njëherë në hapin e 8-të dhe të vendosni datat përsëri.

Për t’u ndryshuar afatat kohore ose datat në sistem të prokurimit elektronik, atëherë të njejtat dhe në format të njejtë duhet të paraqiten/barten edhe në formularin B54 të krijuar në hapin e fundit.

## 14. Adresat dhe kontaktet e përmirësuara




Në këtë hap të dhënat mbeten të pandryshuara

## 15. Teksti i cili duhet të shtohet në njoftimin original




Në këtë hap të dhënat mbeten të pandryshuara, pra nuk duhet të shënoni ndonjë tekst, përveç duhet të shënohet të shtohet ndonjë tekst si informacion i përgjithshëm që ka të bëjë me njoftimin për kontratë dhe Dosjen e Tenderit.  Përndryshe të gjitha ndryshimet dhe shtesat duhet të bëhen nëpërmjet hapit të 13-te.

## 16. Opsionet e publikimit




Në këtë hap duhet të vendoset data e dërgimit të njoftimit për publikim. Duhet patur parasyshë që njoftimi i dërguar me datë 28.04.2025 deri në ora 18:00 publikohet ditën e nesërme me datë 29.04.2025.

## 17. Dosja e Tenderit




Në këtë hap, nëse ndryshimet me B54 përfshijnë vetëm “kushtet e pjesëmarrjes” ose Afateve për dorëzim te ofertave, atëherë nuk duhet të ndryshihet dhe ngarkohet ndonje document apo DT e ndryshuar.

Nëse ndryshimi përfshinë ndryshime ose shtesa në DT (Specifikime Teknike, Terma të Referencës, etj), atëherë Dosjen e Tenderit me ndryshime e ngarkoni/shtoni nëpërmjet butonit “Shto dokument të ri” duke e emërtuar saktë si “Dosje e Tenderit e ndryshuar”.

Nëse ndryshimi përfshinë Përshkrimin e Çmimeve, atëherë ketu nuk ngarkohet asgjë, por ndryshimin e çmimeve duhet bërë nëpërmjet butonit “Ndryshimi i përshkrimit të çmimeve” në kuadër të detajeve të procedurës.

## 18. Anëtarët e komisionit të hapjes së tenderëve




Në këtë hap të dhënat mbeten të pandryshuara – vetëm “Ruaj dhe Vazhdo”

## 19. Të dhënat specifike të prokurimit




Në këtë hap të dhënat mbeten të pandryshuara apo nëse përgaditja e formularit B54 bëhet gjatë fazës së **“Dorëzimit të Tenderëve”** nuk kërkohet që të ri-krijohen çelësat për hapje të ofertave.

Ndërsa, nëse përgaditja e formularit B54 bëhet gjatë fazës kur statusi i procedurës është **“ Në apel”,** atëherë në këtë hap domosdoshmërisht duhet të krijohen **çelësat e rinjë** për anëtarët e komisionit të hapjes.

## 20. Informata shtsë, përmirësimi i njoftimit për kontratë




Në këtë hap duhet të krijoni formularin B54, të cilin duhet t’a shkarkoni dhe kontrolloni nëse të dhënat e vendosura në hapat paraprak jane parqaitur në mënyrë të saktë.

Më poshtë është paraqitur një shembull ilustrues se si duhet të paraqiten të dhënat në formularin B54 të krijuar në hapin e 20 (Pjesa e ndryshimeve).

**NENI IV: INFORMACIONET PLOTËSUESE**

| | | |
|---|---|---|
| **IV.1) KY NJOFTIM PERFSHINE** | | |
| **Përmirësim** ❄ | **Informata shtesë** ○ | |
| **Njoftim për kontrate** ❄ | | |
| **IV.2) INFORMACIONI QE DUHET TE PERMIRESOHER OSE TE SHTOHET** *(nëse aplikohet; te specifikohet vendi i tekstit ose datat te cilat duhet te përmirësohen apo te shtohen, ju lutem gjithmonë ofroni nenet përkatëse & numrin e paragrafit te njoftimit origjinal)* | | |
| **IV.2.1) Modifikimi i informatave origjinale të dorëzuara nga Autoriteti Kontraktues** ❄ | **Publikimi në webfaqen e KRPP-së nuk është në përputhje me informatat origjinale të dorëzuara nga Autoriteti Kontraktues** ○ | **Të dyja** ○ |
| **IV.2.2) Në njoftimin origjinal** ○ | **Në dokumentet e tenderit** ○ | **Të dyja** ❄ |

**IV.2.3) Tekst i cili duhet të përmirësohet/shtohet në njoftimin origjinal** *(nëse aplikohet)*

| Vendi i tekstit i cili duhet të modifikohet: | Në vend të: | **Është :** |
|---|---|---|
| **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** | **Specifiko kerkesen qe duhet ndryshuar** | **Specifiko kerkesen e ndryshuar** |
| **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** | **Specifiko deshmine qe duhet ndryshuar** | **Specifiko deshmine e ndryshuar** |
| **Kapaciteti teknik dhe profesional** | **Specifiko kerkesen qe duhet ndryshuar** | **Specifiko kerkesen e ndryshuar** |
| **Kapaciteti teknik dhe profesional** | **Specifiko deshmine qe duhet ndryshuar** | **Specifiko deshmine e ndryshuar** |
| **Dosja e Tenderit, Pjesa e Specifikimeve teknike** | **Specifiko pjesen e specifikimeve teknike qe duhet ndryshuar** | **Specifiko specifikimet e ndryshuara** |
| **Pershkrimi i çmimeve** | **Specifiko pjesen e pershkrimit te çmimeve qe duhet ndryshuar** | **Specifiko ndryshimin ne Pershkrim te çmimeve** |
| **Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për sqarimin e dosjes së tenderit:** | **22.04.2025** | **22.05.2025** |
| **Afati i fundit për pranim të tenderëve** | **10.05.2025 14:00:00** | **27.05.2025 14:30:00** |
| **Takimi për hapjen e tenderëve** | **10.05.2025 14:00:00** | **27.05.2025 14:30:00** |
| | | |
| **Dosja e Tenderit** | | **Specifiko pjesen e cila shtohet ne DT** |
| | | |
| | | |

------------------------------------- *(Shto nenin IV.2.3 sa here qe keni nevojë)* -------------------------------

Gjithmonë duhet të pasqyrohet si e selektuar opcioni "Te dyja"

Në këtë pjesë duhet të paraqiten të gjitha të dhënat e vendosura në hapin e **12** dhe të cilat llojin e korrigjimit e kanë **"Ndryshon"**

Në këtë pjesë duhet të paraqiten të gjitha të dhënat e vendosura në hapin e **8** dhe **13** lidhur me afatet dhe datat për pranim/hapje te tenderve.

Formati i të dhënave duhet të jetë në këtë formë të paraqitur, përndryshe nuk është bërë ndryshimi i datave në mënyrë të duhur.

Në këtë pjesë duhet të paraqiten të gjitha të dhënat e vendosura në hapin e **12** dhe të cilat llojin e korrigjimit e kanë **"Shtohet"**